



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. **66**

Prishtinë, më 16.3.2010, ora 13,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
nga mbledhja e Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Naser Rugova, Naim Maloku, Zulfi Merxha, Haset Cakolli, Berat Luzha, Elheme Hetemi, Selvie Halimi, Myrvete Pantina, Ali Lajçi, Branislav Grbić, Zef Morina.

Të ftuarit dhe pjesëmarrësit tjerë : zyrtar, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar .

Nga stafi mbështetës i komisionit : Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi **Naser Rugova**, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 23.2.2010,
3. Njoftimi nga Iva Stamenova për vizitën e Komisionit në Bruksel,
4. Të ndryshme.

1. Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes, hapi mbledhjen për pikat e **rendit të ditës** dhe për disa çështje tjera, për të cilat nuk kishte vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar dt. 23.2.2010

Kryetari konstatoi miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

3. Vizita e Komisionit në Bruksel

Kryetari Naser Rugova falënderoi për pjesëmarrje dhe përshëndeti znj. Stamenova duke elaboroua shkurtimisht për interesimin e komisionit për një vizitë në Bruksel pasi që ka marr udhëheqjen e komisionit. Ky komision do të realizonte këtë vizitë e kompletuar për shkak të rëndësisë që do të kishte vizita, ngase është vizitë studimore në Bruksel ku funksionimi i mekanizmave të parlamentit Evropian (bujqësisë dhe mjedisit) do të ishin me rëndësi të

madhe për përvojën e këtij komisioni, i cili gjatë këtij viti do të procedoi afër 20 projektligje në fushën e vet.

Iva Stamenova falënderoi për mikpritje njëkohësisht edhe për kërkesën e komisionit për një vizitë në KE, zyrtarët e së cilës atje në Bruksel kanë mirëpritur këtë interesim të këtij komisioni. Ajo i luti anëtarët e komisionit që në mbledhjen e sotëm të diskutohet modaliteti i vizitës çka dëshirohet të vizitohet dhe kohën e mundshme (çështjet protokollare) duke sugjeruar disa vende me interes për komisionin.

Naser Rugova edhe një herë falënderoi në emër të komisionit duke propozuar dikasteret e mundshme që mund të vizitohen në parlamentin evropian (departamentet për bujqësi, pylltari, mjedis), por e dëshirueshme do të ishte të vizitohen edhe homologët e komisionit në parlamentin evropian, pasi që vizita do të ketë karakter studimor, informativ, rekomandues etj, ndërkaq koha e përshtatshme do të ishte prej fillimit të prillit deri në fillim të muajit maj. Në emër të komisionit propozoi që agenda e vizitës të caktohet nga KE të cilin do ta respektoi ky komision në përpikëri, por fillimisht të dërgohet ftesa (si dëshmi) e cila do të kërkohej nga Kryesia e Kuvendit, si dhe të përgatiten çështjet teknike siç janë sigurimi i vizave për disa anëtarë etj.

Iva Stamenova sugjeroi të vizitohet gjithësej sektori për Kosovën (zyra e zgjerimit) në Belgjikë e cila ndihmon Kosovën dhe disa shoqata (kompani) bujqësore, për çka komisioni plotësisht u pajtua, ndërsa **Elheme Hetemi** nuk kundërshtoi sugjerimin por shtoi se me interes për komisionin do të ishte të shihet atje bashkëpunimi i parlamentit belg me ministrinë dmth të vizitohet ministria e bujqësisë.

Naim Maloku falënderoi në emrin e tij personal për angazhimin dhe miratimin e KE për një vizitë të komisionit në Belgjikë dhe shtoi se ky komision përfshin shumë sektorë të dy ministrive, ndaj është e pamundur për pak ditë të vizitohen gjithë këto departamente. Sugjeroi që komisioni në këtë vizitë të fokusohet në fushën e mjedisit (ku përfshihet edhe pylltaria dhe zhvillimi rural) ngase këtu në Kosovë kemi probleme të mëdha mjedisore të cilat me gjasë do të jenë pengesë mjaft e madhe për integrimet e mëtejme Evropiane. Ligjet e kësaj fushe me përpikëri duhet ti zbatojmë dhe ti monitorojmë, ndërkaq ligjet që hartohen tani e tutje duhet të plotësojnë standardet që kërkohej nga KE të cilat mund ti shohim edhe atje gjatë vizitës.

Komisioni në vazhdim u pajtua si vijon :

K O N K L U Z Ë

Të caktohet agenda e vizitës së këtij komisioni në Bruksel nga ana e përfaqësuesve të KE të cilën do ta prezantoi Iva Stamenova posa të jetë e gatshme, derisa administratori i komisionit duhet të jetë në gatishmëri të kësaj zyreje për çdo informatë që kërkohej.

4. Të ndryshme :

1. Takimi i kryetarit Naser Rugova me Kryetarin e Komisionit për Komunitete z. Miletiq për projektligjin për Banesa

Në këtë takim ku janë përfaqësuar edhe ndërkombëtarët, kryetari **Naser Rugova** tha se ka përfaqësuar qëndrimin që ky projektligj duhet të përfundoj gjithësej deri në mesin e muajit maj, përndryshe do të flitet haptas (do të adresohet fajti) në seancë plenare për pengesat e paraqitura në procedurën parlamentare aspak të shkaktuara nga ky komision si komision funksional. Lidhur me këtë projektligj z. Numan Baliq ka filluar aktivitetin serioz me ndihmën e ekspertit ndërkombëtar që do të sigurohet së shpejti, për të sugjeruar amendamentet e mundshme, tha në fund.

2. Kërkesa e Kryesisë së Kuvendit (Sabri Hamiti)

Lidhur me këtë kërkesë **Naser Rugova** tha se nga kryesia është kërkesa që secili komision të raportoi për fushën e vet për Agjencitë e pavarura që raportojnë Kuvendit. Ky komision ka të bëjë me dy organe të tilla siç janë ZRRUM dhe Këshilli për Ujëra, ndaj u kërkua nga administratori i komisionit të përgatit shënime për këto dy organe si funksionojnë, shënime këto që do të shërbejnë për ftesën e mëtejme për kryetarët e komisioneve me anëtarin e kryesisë z. Sabri Hamitin.

Ai më tutje njoftoi komisionin për shkresën e dërguar nga udhëheqësi i ZRRUM z. Afrim Lajqi i cili njofton se mandati i tij kalon më 31 mars 2010 ndërkaq ende nuk ka emërim të udhëheqësit në këtë organ.

Naim Maloku njoftoi se pikërisht sot kryesia ka adresuar këtë komisioni të shqyrtoi propozimin e Qeverisë për emërimin e drejtorit dhe zv. drejtorit në këtë organ, propozim ky i cili në vitin e kaluar është refuzuar nga seanca plenare, dhe asgjë nuk ka ndryshuar dmth është sjellë prapë i njëjti propozim pa kurfar ndryshimi, ndaj ai parashtroi dilemën në njëerën anë për këtë komision a duhet të shqyrtohet propozimi nga zyra ligjore apo nga ky komision ngase prapë sillet e njëjta gjë, si dhe në anën tjetër për Kuvendin dilema a duhet të mirët Kuvendi me një propozim të njëjtë që është shqyrtuar një herë nga seanca plenare.

3. Kërkesa nga Oda Ekonomike

Kjo kërkesë e nënshkruar nga udhëheqësi i Odës z. Besim Beqaj, vazhdoi kryetari, ka të bëjë me gatishmërinë që shprehet nga Oda Ekonomike për të marr pjesë në punën e komisionit me një përfaqësues gjatë shqyrtimit të projektligjeve që do të dërgohen në Kuvend rreth Blegtorisë, Verërave, Farërat, Shërbimet Këshillimore dhe kultivimin e Duhanit.

Komisioni shprehu kënaqësinë dhe sugjeroi administratorin të njoftoi organin përkatës që janë të mirëseardhur për bashkëpunim dhe do të ftohen rregullisht posa të mbërrijnë projektet përkatëse në Kuvend.

4. Kërkesa e Kryetarit të Komunës së Obiliqit

Mehmet Krasniqi kryetar i komunës në Obiliq, në shkresën e tij alarmon për gjendjen mjedisore në këtë komunë (të cilën shkresë **Elheme Hetemi** kërkoi që të dorëzohet secilit anëtarë të komisionit), ndaj kërkon angazhimin e komisionit në këtë drejtim.

Naser Rugova konstatoi që fillimisht duhet të vizitohet MMPH dhe të shikohet çka sugjerojnë këta zyrtar, ngase **Elheme Hetemi** ishte e mendimit se e kotë do të ishte vizita në Obiliq nëse fillimisht nuk mirën njoftimet zyrtare nga ministria e Mjedisit.

Blerim Vela njoftoi se 72% e sipërfaqes së komunës së Obiliqit është e shpallur zonë e interesit kombëtar, gjë që kufizon autoritet komunale në realizimin e projekteve të saja. Autoritetet komunale ishin përfshirë në hartimin e vlerësimit mjedisor të termocentralit 'Kosova e Re' me kapacitet prej 2100 MW. Me ndërrimet e bëra gjatë vitit të kaluar në projektin 'Kosova e Re', Komuna nuk është njoftuar apo përfshirë rreth vlerësimit mjedisor të projektit të ri me kapacitet prej 1000 MW.

Naim Maloku mendoi se me këtë veprim komisioni mund të tejkaloi obligimet që i takojnë ngase Qeveria është niveli të cilit i takojnë të mirët me këtë problem dhe me projektet e parapara në këtë komunë, prandaj duhet të ftohet ministria e mjedisit dhe të pyetet se ku qëndron momentalisht çështja e ndotjes në komunën e Obiliqit, gjithashtu edhe çështja e fshatit Hade deri ku ka mbërrijt, në mënyrë që vizita në Obiliq të jetë përmbajtësore.

Elheme Hetemi konstatoi se komisioni megjithatë ka kompetencat e duhura dhe të mjaftueshme të cilat i ka marr edhe në bazë të rekomandimeve të fundit nga Kuvendi, ndaj sugjeroi që para se të miratohet strategjia për energji të enjten, ky komision të bashkëpunoi në këtë frymë me MMPH dhe pastaj të epen sqarimet e duhura në komunën e Obiliqit.

Naser Rugova u pajtua me këtë hierarki të veprimeve që duhet të ndërmarrën, së pari të shkohet në departamentin përkatës në MMPH lidhur me problemet mjedisore më lartë cekura, të debatohet strategjia energjetike (me të cilin tha se nuk është i kënaqur aspak sepse nuk ka kosto financiare dhe afate), sepse ky komision ka drejt të informohet kush shkakton probleme mjedisore dhe sa po mbrohet mjedisi.

Komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

- 1. Të vizitohet Ministria e Mjedisit gjatë javës së ardhshme (të konsultohet zyra e ministrit për kohën e vizitës) lidhur me politikat mjedisore për komunën e Obiliqit, ndërkaq në javën e fundit të këtij muaji të vizitohet komuna e Obiliqit dhe instituti INKOS duke shfrytëzuar fondin financiar të komisionit për një drekë pune me zyrtarët e Komunës dhe të INKOS-it.**
- 2. Pas vizitës në Bruksel të organizohet një debat publik jashtë komunës së Prishtinës sipas sugjerimeve nga KFOS lidhur me politikat mjedisore, veprimet të cilat duhet të ndërmirën në vendet (rajonet) e rrezikuara nga ndotja etj.**

Mbledhja e komisionit përfundoi në orën 14,01. Mbledhja e radhës do të mbahet pas dy vizitave në MMPH dhe në Obiliq.

Kryetari i Komisionit,
Naser Rugova